

## BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR PRILL-QERSHOR 2008

Në 3 prill, 2008, në mjediset e hotel "Tirana International" u zhvillua forumi i Bankës së Shqipërisë me tematikë: Mbikëqyrja bankare , stabiliteti financiar dhe funksionimi i tregut të parasë e atij financiar. Të pranishëm në forumin e konceptuar në formën e një tryeze të rrumbullakët, qenë aktorët kryesorë të sistemit financiar dhe përfaqësues nga 16 banka tregtare, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Ky aktivitet përfaqëson një tjetër përpjekje të Bankës së Shqipërisë për të nxitur komunikimin e vazhdueshëm me sistemin financiar në përgjithësi, e atë bankar në veçanti, si edhe një traditë të saj, e cila synon përsosjen e tregut financiar dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit.

*"Mbikëqyrja, stabiliteti financiar dhe funksionimi i tregut të parasë dhe atij financiar". Forumi i Bankës së Shqipërisë me aktorët e sistemit financiar.*

Në fjalën e mbajtur për këtë rast, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, ngriti një sërë çështjesh, si : nevojën për një komunikim periodik mes Bankës së Shqipërisë dhe aktorëve të sistemit financiar; shqetësimin e Bankës së Shqipërisë për vijimin e akordimit në valutë të pjesës më të madhe të kredisë konsumatore dhe të kredisë për hipoteka; transparencën e sistemit bankar kundrejt publikut; përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes së bankave; mirëfunksionimin e tregut ndërbankar; rritjen e lëvizjes së fondeve ndërmjet sistemit; forcimin e kontrollit të brendshëm të bankave tregtare, si edhe publikimin e rezultateve të aktivitetit bankar.

Në këtë takim u prezantua edhe përgatitja e një pakete rregullash të Bankës së Shqipërisë, me qëllim rritjen e kujdesit në drejtim të stabilitetit të sistemit bankar. Në thelbin e saj paketa synon: një disiplinim më të mirë të sistemit bankar në drejtim të vlerësimit të rreziqeve që lidhen me kredinë; penalizimin e bankave kur shtohen kreditë me probleme; nxitjen e kreditimit në monedhën kombëtare; si dhe rritjen e transparencës dhe sqarimit të klientelës për çdo produkt apo shërbim.

Në 25 prill, 2008, në sallën "Black Box", në Akademinë e Arteve të Tiranës, u organizua faza finale e konkursit "Vlera e Vërtetë e Parasë", konkurs që Banka e Shqipërisë organizoi për nxënësit e shkollave të mesme të kryeqytetit. Viti mësimor 2007- 2008, ishte viti i parë që Banka e Shqipërisë organizoi një konkurs të tillë , gjithashtu i pari në llojin e tij në të gjithë vendin. Ai u zhvillua në 2 faza atë eliminatorë dhe atë finale, të cilat u ndoqën nga afër prej afro 600 spektatorësh. Faza finale, e cila u fitua prej shkollës së mesme të përgjithshme "Qemal Stafa", në Tiranë, u transmetua në Televizionin Publik Shqiptar.

*Mbyllet konkursi "Vlera e Vërtetë e Parasë" për vitin shkollor 2007-2008.*

Tema kryesore e tij lidhet pikërisht me funksionin kryesor të bankës qendrore, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikës së

saj monetare. “Vlera e Vërtetë e Parasë” përngjan me një konkurs klasik, ku skuadra nxënësish të përbëra prej tri pjesëtarësh, konkurrojnë mes tyre duke iu përgjigjur një sërë pyetjesh të drejtuara prej panelit të Jurisë, të përbërë nga pesë anëtarë dhe të kryesuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Faza eliminatorë u zhvillua në hollin e Bankës së Shqipërisë, në datat 2 dhe 4 prill. 20 ekipet pjesëmarrëse u përballën me njëri tjetrin të ndarë në grupe me nga 5 shkolla. Ekipet konkurruan për rreth 90 minuta përpara panelit të jurisë. Ata iu përgjigjën një grupi të larmishëm pyetjesh, si pyetje me shtjellim, pyetje rrufe, pyetje kuis, pyetje me plotësim termash, një zgjidhje ushtrimi, një interpretim grafiku, duke e mbyllur konkurrimin me përgjigjen e një pyetjeje, të përgatitur nga vetë ekipet pjesëmarrëse për njëri tjetrin. Skuadrat, të cilat u paraqitën më mirë për sa i përket njohurive mbi materialin përgatitor, aftësi analitike të argumentit, aftësi prezantuese dhe punës në grup janë: “Qemal Stafa”, “Sami Frashëri” dhe “Besnik Sykja”.

Ky aktivitet është pjesë e programit edukues gjithëpërfshirës “Banka Qendrore në Jetën e Përditshme”, i cili synon të krijojë një kulturë të vërtetë ekonomike-financiare për të gjitha grupet e interesit dhe grupmoshat e ndryshme, duke zhvilluar aktivitete edukuese për secilin prej tyre. Megjithëse, “Vlera e Vërtetë e Parasë” nisi si një konkurs për shkollat e mesme të Tiranës, në vitet në vijim ai do të organizohet edhe në qytete të tjera të vendit, me synimin për t’u kthyer në një aktivitet edukues kombëtar.

*Takimet e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, gjatë zhvillimit të Mbledhjeve të Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Grupit të Bankës Botërore*

Në datat 12-16 prill 2008, z. Ardian Fullani, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Guvernatori i Republikës së Shqipërisë pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në krye të një delegacioni të Bankës së Shqipërisë, mori pjesë në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB) si dhe në Forumin Ekzekutiv të bankave qendrore me temë “Administrimi i aseteve dhe i rezervave valutore”, organizuar nga Departamenti i Thesarit të Bankës Botërore.

Gjatë qëndrimit të tij në Washington D.C., Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, së bashku me Ministrin e Financave, z. Ridvan Bode, zhvilloi takime me përfaqësues të lartë të FMN-së dhe të BB-së.

Në takimet e tij me përfaqësues të lartë të FMN-së përveç diskutimeve të përvitshme mbi zhvillimet e fundit ekonomike dhe financiare në nivel botëror, rajonal dhe shqiptar, z. Fullani bëri një përshkrim të gjatë të zhvillimeve në tregun financiar dhe bankar, duke u ndalur në çështje që lidhen me stabilitetin financiar, me zhvillimet në tregun e parasë dhe punën e bërë prej Bankës së Shqipërisë për zhvillimin e këtij tregu.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e FMN-së shprehën mbështetjen për masat e ndërmarra dhe punën e bërë nga ana e Bankës së Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë, ata vlerësuan arritjet e Bankës së Shqipërisë në drejtim të ankorimit në publik të pritshmërive inflacioniste. Gjithashtu, përfaqësuesit e FMN-së shprehën gatishmërinë për të mbështur Bankën e Shqipërisë me programe të

asistencës teknike, edhe në vazhdim. Në kuadër të takimeve me përfaqësues të lartë të BB, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë i njohu ata me zhvillimet makroekonomike në Shqipëri, me zhvillimet e tregut financiar dhe atij bankar si dhe me synimet e Bankës së Shqipërisë për mbajtjen nën kontroll të inflacionit dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Ashtu si edhe në takimet e mëparshme, një vëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimeve në sektorin energjistik si dhe nevojës urgjente për kryerjen e reformave strukturore në këtë sektor.

Në vijim të qëndrimit të tij në Uashington, z. Fullani mori pjesë edhe në Forumin Ekzekutiv të Bankave Qendrore të organizuar prej Departamentit të Thesarit të Bankës Botërore, me temë "Administrimi i Aseteve dhe i Rezervave Valutore të Bankave Qendrore".

Temat kryesore të trajtuara në këtë Forum kishin të bënin me kuadrin e vendimmarrjes, në lidhje me politikat e investimit të aseteve dhe të rezervave valutore, operacionet e investimit, administrimin e rrezikut, shpërndarjen strategjike të aseteve si dhe me çështjet e diversifikimit të mjeteve të rezervës valutore.

Në datë 30 prill, 2008 Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani zhvilloi një takim me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse dhe institucioneve të specializuara në fushën e edukimit e të çështjeve sociale.

Ky takim shënoi edhe fillimin e takimeve të organizuara nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë në hollin e saj. Të ftuarit do të jenë përfaqësues të grupeve të ndryshme shoqërore dhe qëllimi i tyre kryesor, zhvillimi i bisedave të hapura mes Guvernatorit dhe të pranishmëve. Takimet kanë për objekt bashkëpunimin lidhur me çështjet e edukimit ekonomik dhe financiar, që Banka e Shqipërisë synon të ketë me institucionet, dhe organizatat që të ftuarit përfaqësojnë.

Argumentet kryesore të këtij takimi të parë në hollin e Bankës së Shqipërisë qenë prezantimi i broshurës edukative "Ndërtoni të ardhmen- Planifikoni të ardhurat tuaja" dhe programi i edukimit për punonjësit socialë në fushën e bankingut qendror, atij tregtar, dhe çështjeve të tjera të lidhura me edukimin ekonomik-financiar të publikut të gjerë.

"Ndërtoni të ardhmen- Planifikoni të ardhurat tuaja" është e hartuar me qëllim që të ndihmojë në organizimin financiar të jetës së përditshme të gjithësecilit; në administrimin sa më të mirë të të ardhurave ; në orientimin drejt mënyrave të duhura për të shtuar kursimet e tyre apo për të rritur fitimet. Ajo plotëson kërkesën për njohuri financiare dhe bankare të disa grupeve shoqërore: të atyre që jetojnë vetëm dhe duan të administrojnë drejt paratë e tyre; të grave shtëpiake që kujdesen për të ardhurat e familjeve të tyre; të njerëzve që punojnë dhe duan të administrojnë drejt kursimet e tyre dhe të familjes; të atyre që kanë filluar të përgatiten për moshën e pensionit.

*"Ka gjithmonë diçka më shumë për të mësuar për paratë".  
Takimi i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani dhe përfaqësues të organizatave jofitimprurëse dhe të institucioneve të specializuara në fushën e edukimit dhe të çështjeve sociale.*

Programi i edukimit për punonjësit socialë është një tjetër aktivitet që Banka e Shqipërisë do të ndërmarrë për çdo vit dhe i dedikohet të sapodiplomuarve në degën e punës sociale. Ky seminar do të zhvillohet 4 herë në vit dhe do të trajtojë tema që lidhen me bankën qendrore, me rolin e saj në zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë dhe në jetën e përditshme të gjithsecilit. Nëpërmjet këtyre individëve dhe për arsye të profesionit të tyre, Banka e Shqipërisë synon të arrijë tek publiku i gjerë ose më mirë, tek të gjithë ata, që për arsye të ndryshme, kanë kontakt me përfaqësuesit e organizatave dhe institucioneve të lartpërmendura.

Aktivitete të këtij lloji, të cilat i përkushtohen edukimit të publikut mbi çështje të lidhura me bankën qendrore dhe edukimin ekonomik financiar, janë pjesë e programit të edukimit "Banka Qendrore në Jetën e Përditshme", të Bankës së Shqipërisë. Bëhet fjalë për një program gjithëpërfshirës, të ideuar për grupime të ndryshme të popullsisë.

*"Banka Qendrore në jetën të përditshme". Vizita e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani në shkollën e mesme të përgjithshme "Ali Demi", Vlorë.*

Në datë 13 qershor 2008, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani kreu një takim me nxënës dhe mësues të shkollave të mesme të rrethit të Vlorës me qëllim lançimin edhe në këtë qytet të programit edukues "Banka Qendrore në jetën e përditshme". Në kuadër të këtij programi, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar në qytetin e Tiranës, përgjatë dy viteve të njëpasnjëshëm '07-'08, aktivitete të ndryshme edukuese, si: seminare trainuese me mësuesit e ekonomisë në shkollat e mesme; me gazetarët e rubrikave ekonomike në media; takime në shkollat e mesme të Tiranës, janë shkruar broshura edukuese mbi argumente të rëndësishme të Bankës Qendrore e të bankingut tregtar; takime dhe leksione të Guvernatorit me studentë dhe profesorë të Tiranës e jo vetëm etj..

Takimi u zhvillua në mjediset e shkollës së mesme të përgjithshme "Ali Demi". Ai u ndoq prej rreth 150 vetash, nxënës, mësues dhe përfaqësues të Drejtorisë Arsimore të rrethit të Vlorës.

Në Vlorë, ashtu si edhe në Tiranë programi do të nisë me organizimin e seminareve trainuese për mësuesit e ekonomisë së zbatuar të shkollave të mesme të rrethit të Vlorës, gjatë verës së këtij viti. Hapi i dytë do të jetë organizimi i konkursit "Vlera e Vërtetë e Parasë", për vitin shkollor 2008-2009.

Në fjalimin e mbajtur me këtë rast, në mjediset e shkollës "Ali Demi", z. Fullani midis të tjerave i foli të pranishmëve për rëndësinë e krijimit të një kulture të mirëfilltë ekonomik-financiare në mirëqenien e gjithsecilit por edhe në mbarëvajtjen e ekonomisë shqiptare, në përgjithësi. Ambiciet e Bankës së Shqipërisë në fushën e edukimit ishin një tjetër temë e prekur nga z. Fullani. Ai u shpreh se edukimi është një çështje që u takon të gjithëve dhe se Banka e Shqipërisë synon ta shndërrojë informacionin dhe literaturën që lidhet me këtë fushë, në lehtësisht të kuptueshëm për të gjithë.

Ai gjithashtu, i njohu ata me mënyrat se si Banka e Shqipërisë mundohet të përçojë mendësinë, punën dhe edukimin ekonomik-financiar tek publiku i ri, në mënyrë argëtuese.

Në mbyllje të aktivitetit Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani iu përgjigj pyetjeve të nxënësve mbi mënyrat e komunikimit të publikut me përfaqësues të Bankës mbi tema specifike të bankingut qendror, atij tregtar etj., mbi faqen web të Bankës së Shqipërisë posaçërisht për moshat e reja, mbi krizën financiare botërore etj..

Pas takimit të gjithë nxënësve pjesëmarrës iu shpërndanë pyetësorë, të përgatitur me qëllim njohjen e interesit dhe njohurive të tyre mbi Bankën e Shqipërisë dhe aktivitetet e saj edukuese.

Në datë 5 maj, 2008, një delegacion i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (AQBK), i kryesuar nga z. Hashim Rexhepi, Drejtor i Përgjithshëm, zhvilloi një vizitë zyrtare në Bankën e Shqipërisë. Kjo ishte dhe vizita e tij e parë zyrtare si Drejtor i AQBK në Bankën e Shqipërisë. Delegacioni u prit në një takim nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani dhe nga z. Fatos Ibrahim, Zëvendësguvernator i Parë.

*Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë me delegacionin e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.*

Guvernatori Fullani shprehu vlerësimin për kapacitetet mjaft të mira administrative të AQBK-së, të cilat do të mundësojnë transformimin e plotë të këtij institucioni në një bankë të mirëfilltë qendrore. Ai theksoi se Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë gjithnjë e gatshme, për të ofruar të gjithë mbështetjen dhe ekspertizën e nevojshme për AQBK-në si dhe shprehu bindjen se forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit teknik do të sjellë përfitime për të dy institucionet.

Nga ana e tij, z. Rexhepi bëri një paraqitje të punës së AQBK-së për krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe operacional, me qëllim përgatitjen e funksionimit të AQBK-së si një bankë e mirëfilltë qendrore, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në datën 15 qershor 2008. Ai theksoi se struktura udhëheqëse e AQBK-së mbetet e vetëdijshme për rolin mjaft të rëndësishëm që banka qendrore do të ketë në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe sfidat që e presin atë në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, z. Rexhepi shprehu mbështetjen e tij të plotë për intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh.

Në delegacion ishte i pranishëm edhe z. Gazmend Luboteni, Kryetar i Bordit Drejtues të AQBK. Ai u shpreh se forcimi i bashkëpunimit teknik në fushën e mbikëqyrjes bankare, të fuqizimit të burimeve njerëzore si dhe mbështetja e Bankës së Shqipërisë me ekspertizë teknike janë me shumë rëndësi për AQBK dhe veçanërisht, për Bankën e ardhshme Qendrore të Republikës së Kosovës.

Z. Luboteni gjithashtu, kërkoi mbështetjen e Bankës së Shqipërisë në lidhje me përfshirjen e AQBK-së në rrjetet e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet bankave qendrore.

Takimi vijoi me diskutimin dhe shkëmbimin e mendimeve në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare respektive, në përgjithësi dhe atyre

bankare, në veçanti, me një fokus të veçantë në mbikëqyrjen e kujdeshme të aktorëve të tregut financiar dhe në sigurimin e stabilitetit financiar në të dyja vendet.

*Cikli i seminareve për mësuesit e shkollave të mesme, viti shkollor 2007-2008.*

Në datë 5 dhe 6 maj, 2008 u organizua ceremonia e mbylljes së ciklit të seminareve të përvitshme trajnuese, që Banka e Shqipërisë organizon për mësuesit e shkollave të mesme të kryeqytetit, që prej dy vjetësh. Këto seminare dyditore, pjesë e programit edukues "Banka Qendrore në jetën e përditshme" zhvillohen katër herë në vit, përgjatë gjithë vitit mësimor dhe synojnë të thellojnë e të pasurojnë njohuritë e mësuesve mbi bankingun qendror, Bankën e Shqipërisë dhe rolin e saj në ekonominë e vendit. Specialistë dhe drejtues nga departamente të ndryshme të Bankës së Shqipërisë, kryejnë prezantime dhe biseda mbi çështjet e lartpërmendura, por edhe mbi të tjera të kërkuara prej vetë mësuesve.

Nëpërmjet organizimit të këtyre seminareve, Banka e Shqipërisë ka arritur të vendosë marrëdhënie ndërvepruese edukimi me ata, që më mirë se kushdo tjetër mund të përçojnë aktivitetin dhe mendësinë e Bankës sidomos tek të rinjtë, tek nxënësit e tyre, por edhe tek të afërmit, miqtë dhe kolegët. Ashtu siç u shpreh dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani gjatë ceremonisë së shpërndarjes së certifikatave, për ciklin e seminareve të vitit mësimor 2007-2008 "...ne në Bankë mendojmë që ekonomia dhe financat, si çdo gjë tjetër, duhen mësuar! E sigurisht që vendi më i mirë për të mësuar është shkolla, dhe mësuesit jeni ju!".

Gjatë dy viteve të fundit mësimore, mbi 65 mësues të lëndës së ekonomisë të shkollave të mesme të Tiranës, kanë ndjekur me interes dy ciklet e seminareve të organizuara nga Banka e Shqipërisë për kualifikimin e mëtejshëm të tyre dhe janë pajisur me certifikata pjesëmarrjeje, për këto aktivitete.

Për vitin mësimor 2008-2009 seminarët me mësuesit e shkollave të mesme do të zhvillohen edhe në rrethet e Vlorës, e Shkodrës.

*Vizita e delegacionit të Bankës Qendrore të Suedisë në Bankën e Shqipërisë.*

Në datat 12-17 maj 2008, dy ekspertë të Bankës Qendrore të Suedisë vizituan Bankën e Shqipërisë dhe zhvilluan një periudhë trajnimi me specialistë të Departamentit të Politikës Monetare dhe atij të Kërkimeve.

Ky seminar kishte për qëllim të njëjtte specialistët e të dy departamenteve me metodat moderne të parashikimit të inflacionit, më saktësisht modelet e përdorura nga Banka Qendrore e Suedisë, si edhe modelet makroekonomike të bankave qendrore të vendeve me ekonomi të zhvilluar.

Gjatë dy ditëve të trajnimit, u diskutua mbi modelet e parashikimit për inflacionin dhe modelin MEAM (modeli makroekonomik) të Bankës së Shqipërisë. Pas një prezantimi të shkurtër të modeleve dhe procesit vendimmarrës në Bankën e Shqipërisë diskutimet u zhvilluan në dy grupe të veçanta sipas përkatësisë së departamenteve.

U vlerësua fakti që këto modele, shfrytëzojnë gati të gjitha të dhënat e disponueshme mbi ekonominë shqiptare dhe përdorimi i rezultateve të tyre i shërben realisht procesit të vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë.

Në datë 13 maj, 2008 Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani dhe Drejtorja e Përgjithshme e Institutit të Statistikave (INSTAT), zj. Ines Nurja, nënshkruan një Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe INSTAT-it.

*Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Institutit të Statistikave.*

Nëpërmjet zbatimit të këtij memorandumi, Banka e Shqipërisë do të rrisë numrin e produkteve statistikore që merren nga INSTAT-i në kuadrin e vlerësimeve të fazës së re të zhvillimit ekonomik në të cilën po hyn vendi. Në të njëjtën kohë, zbatimi i këtij memorandumi do t'i mundësojë INSTAT-it pasurimin e mëtejshëm të spektrit të të dhënave statistikore me të dhëna nga sektori financiar dhe sektori i jashtëm, të cilat prodhohen nga Banka e Shqipërisë.

Plotësimi me saktësi i kërkesave të paraqitura në këtë memorandum, përbën një bazë të mirë edhe për plotësimin e një sërë detyrimeve që kanë statistikat shqiptare, për të përmbushur standardet ndërkombëtare. Në memorandum përcaktohen detyra konkrete për plotësimin me saktësi të kërkesave të shtruar nga projekti i "Standardeve të Specializuara të Shpërndarjes së të Dhënave" (Special Data Dissemination Standard – SDDS Project) të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që do të mundësojë nga ana statistikore përfshirjen e Shqipërisë në tregjet financiare ndërkombëtare. Ndërkohë, plotësimi i këtyre standardeve si dhe i kërkesave të tjera të parashikuara në programet ekzistuese të zhvillimit të statistikave në institucionet statistikore shqiptare, sigurojnë një shtrat bashkëkohor të plotësimit të standardeve evropiane për statistikat tona.

Njëri prej aktiviteteve të programit edukues të Bankës së Shqipërisë "Banka Qendrore në jetën e përditshme" është dhe organizimi i takimeve në pothuaj të gjitha shkollat e Tiranës. Në këto takime drejtuesit e specialistët e Bankës së Shqipërisë kryejnë biseda mbi funksionin e saj, mbi sistemin bankar dhe administrimin e financave personale.

*Përfundimi i takimeve në shkollat e mesme të kryeqytetit, viti mësimor 2007-2008.*

Për vitin mësimor 2007-2008 cikli i takimeve u mbyll me atë të shkollës së mesme të përgjithshme "Myslym Keta", në datë 13 maj, 2008. Në kuadër të këtij aktiviteti, vetëm për vitin mësimor që sapo kaloi, në 13 shkolla të mesme të kryeqytetit janë zhvilluar takime e biseda me rreth 500 gjimnazistë të viteve të treta. Prej këtyre takimeve janë përfutuar gjithashtu edhe rreth 400 pyetësorë, të cilët pasqyrojnë opinionet e mësuesve dhe nxënësve në lidhje me aspektet më kryesore të programit edukativ, që Banka e Shqipërisë ndërmori gjatë periudhës 2007-2008.

Banka e Shqipërisë planifikon t'i zgjerojë këto takime edhe në rrethe të tjera të vendit. Përkatësisht, për vitin mësimor 2008- 2009 dy qytetet e zgjedhura janë Vlora dhe Shkodra.

*Takimi XIX i Klubit të Guvernatorëve të Bankave Qendrore të vendeve të Azisë Qendrore, të Rajonit të Detit të Zi dhe të Ballkanit.*

Në datat 23-24 maj 2008, nën kujdesin e veçantë të z. Ardian Fullani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Zëvendëskryetar i Klubit të Guvernatorëve të Bankave Qendrore të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit për vitet 2007-2008, u zhvillua në Tiranë Takimi XIX i këtij Klubi.

Në këtë takim, morën pjesë guvernatorët e Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës, të Bankës së Greqisë, të Bankës Kombëtare të Kazakistanit, të Bankës Qendrore të Malit të Zi, të Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë, të Bankës Qendrore të Federatës Ruse, si dhe Guvernatori i Bankës Kombëtare të Serbisë, i cili është dhe aktualisht Kryetari i Klubit.

Në të njëjtën kohë, pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe Zëvendësguvernatori i Bankës Kombëtare të Moldavisë, Zëvendësguvernatori i Bankës Kombëtare të Rumanisë, Zëvendësguvernatori i Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë si dhe përfaqësues të bankave qendrore të Azerbaixhanit, Republikës Kirgize, Bullgarisë dhe Izraelit.

Takimi i Tiranës u përshëndet nga Zëvendëspresidenti i Bankës Qendrore Evropiane, z. Lucas Papademos, i cili mbajti edhe një fjalim rreth përballimit të trazirave të tregjeve financiare me fokus në rifitim të besimit dhe përforsimin e aftësisë përtëritëse të sistemit financiar. Takimi vijoi me fjalimet e z. Athanasios Orphanides, Guvernator i Bankës Qendrore të Qipros, i cili prezantoi përvojën qipriote në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në Eurozonë si dhe me prezantimin e z. Mario I. Blejer, ish-Guvernator i Bankës Qendrore të Argjentinës, i cili u përqendrua në sfidat kryesore me të cilat përballen aktualisht bankat qendrore në vendet në zhvillim. Sesion i fundit i Takimit konsistoi në prezantimet nga ana e përfaqësuesve të bankave qendrore pjesëmarrëse rreth zhvillimeve ekonomike në vendet përkatëse, me një theks të veçantë në ecurinë e sistemeve financiare në përgjithësi, dhe atyre bankare në veçanti si dhe në veprimtarinë e bankave qendrore në këto vende.

Klubi i Guvernatorëve, i themeluar në vitin 1998, përfaqëson një forum të bankave qendrore, i cili synon të përforcojë marrëdhëniet ndërmjet bankave qendrore të rajonit, të promovojë bashkëpunimin në çështjet monetare, financiare dhe bankare si dhe të nxisë shkëmbimin e përvojave kombëtare në një mjedis të hapur dhe të drejtpërdrejtë. Banka e Shqipërisë është anëtare e këtij Klubi që prej krijimit të tij.

*Seminari i Bankës së Shqipërisë me punonjësit socialë të Tiranës.*

Për herë të parë këtë vit, Banka e Shqipërisë zhvilloi një seminar trajnues me të sapodiplomuarit në degën e punëve sociale. Ky seminar zhvillohet një javë në vit dhe aktualisht, trajton tema që lidhen me bankën qendrore dhe edukimin ekonomik-financiar. Nisur nga fakti që Banka e Shqipërisë e ka të vështirë të kontaktojë drejtpërdrejt me publikun në përgjithësi, ndihma e punonjësve socialë për përcimin e informacionit është vlerësuar si mjaft e dobishme. Dhe kjo për vetë natyrën e profesionit të pjesëmarrësve, të cilët kanë kontakte të shpeshta me shtresa të ndryshme të popullsisë.

Për vitin 2008 ai u mbyll me një ceremoni për shpërndarjen e certifikatave nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, për rreth 60 pjesëmarrës, në datë 16 qershor, 2008, në mjediset e hotel "Tirana International". Duke filluar që prej këtij muaji pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në seminar u regjistruan në listën elektronike të përfituesve të botimeve të Bankës së Shqipërisë.

Në datat 18-20 qershor 2008 në hotel "Tirana International", Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me FSVC, organizoi seminarin me temë "Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit IAS/IFRS". Ky seminar, u zhvillua pas konsultimeve dyditore të grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, me grupin e ekspertëve. Pjesa thelbësore e diskutimeve kishte të bënte me ndikimin që implementimi i standardeve ka në pasqyrat financiare të bankave të niveli të dytë.

*Seminari "Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit IAS/IFRS"*

Krahas çështjeve të mësipërme, në seminar u trajtuan edhe çështje si; përcaktimi i hapave gradualë në drejtim të zbatimit të standardit IAS 39 "mbi njohjen dhe matjen e aseteve dhe detyrimeve financiare" apo metodologjia e përdorur nga bankat për krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, sipas IFRS-së. Kjo e fundit u cilësua si e rëndësishme, për vet ndikimin që këto fonde kanë në rezultatin financiar të bankës.

Kalimi nga aplikimi i standardeve kombëtare në ato ndërkombëtare, përfaqëson një sfidë në vetvete, si për bankat e sistemit të cilat duhet të fillonin të raportonin këtë ndryshim që në muajt e parë të këtij vitit, ashtu edhe për inspektorët e Departamenti të Mbikëqyrjes.

Që prej janarit të vitit 2007, Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, organizon aktivitetin e quajtur "Seminari i të Premtes". Ky seminar fton të gjithë nëpunësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe institucionet e tjera financiare, kërkimore dhe shkencore, të prezantojnë dhe diskutojnë me njëri-tjetrin punët e tyre kërkimore teorike dhe empirike.

*"Seminari i të Premtes"*

Ekonomistët e bankave qendrore përballen gjithmonë e më shumë me kërkesa të politikbërësve, tregut financiar dhe bankar por edhe të publikut në përgjithësi, për analiza. Analizat e tyre janë gjithashtu edhe një ndihmesë për përmbushjen e funksionit kryesor të një banke qendrore, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe atij financiar. Analizat ekonomike përfaqësojnë shtyllën kurriore të politikbërjes së bankingut qendror modern dhe luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e tregut e publikut, si edhe në formimin e pritshmërive. Gjenerimi i analizave mbi variablat ekonomike kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe lidhjet midis të dyve, në kohën e duhur dhe në mënyrë të kuptueshme, është me shumë rëndësi për besueshmërinë dhe pavarësinë e politikës monetare. Gjithashtu, aftësia për të kuptuar dhe modeluar sjelljen e tregjeve financiare, dhe pjesëtarëve të tyre i krijon mundësinë bankës qendrore të identifikojë rreziqet që mund të kenë ndikim mbi ekonominë, t'i rendisin ato sipas shkallës së rrezikshmërisë dhe probabilitetit, dhe të këshillojnë

politikbërësit mbi ndjekjen e politikave më të përshtatshme për të eliminuar ose zbutur këto rreziqe.

Ky aktivitet ofron një mundësi të mirë për të përforcuar dhe lehtësuar komunikimin ndërmjet Bankës së Shqipërisë, universiteteve, institucioneve të tjera kërkimore dhe shkencore që analizojnë zhvillimet ekonomike në Shqipëri, si edhe për të ndihmuar në tejçimin e njohurive nga studiuesit tek vendimmarrësit.

Seminari zhvillohet për çdo dy javë në mjediset e Bankës së Shqipërisë dhe ka një ndërprerje dymujore gjatë muajve korrik dhe gusht. Ai zhvillohet përgjatë një hapësire kohore prej 60- 90 minutash dhe koha e vënë në dispozicion të autorit për prezantimin e materialit është rreth 30-40 minuta. Pjesa e mbetur shfrytëzohet për pyetjet dhe komentet mbi materialin e prezantuar.

Deri më sot në këtë seminar janë prezantuar 26 tema nga 27 persona. Kryesisht nga punonjësit e departamenteve të ndryshme të Bankës së Shqipërisë, në pjesën më të madhe të rasteve prej atij të Kërkimeve dhe të Politikës Monetare.